



ALBANSKA / SHQIP

Sport – një start i mirë në jetë

Sporti u jep fëmijëve dhe të rriturve mundësi të lëvizin, sfidojnë veten dhe të kënaqen bashkë. Në një shoqatë sporti ti mund të ndjehesh pjesë e një bashkësie dhe të zësh shoqëri të re. Këtu, ne u spjegojmë se si funksionon sporti në Suedi dhe se si mund të anëtarsohesh në një shoqatë sporti.

E HAPUR PËR TË GJITHË

Ekzistojnë afërsisht 19 000 shoqata sporti në Suedi ku të gjithë që duan mund të bëhen anëtarë. Nuk luan rol se kush je, nga je, cilin religjion ke, cilën gjuhë e fletë apo në cilën pjesë të Suedisë banon. Një shoqatë

sporti është e hapur për të gjithë, si për fëmijë ashtu edhe për të rritur. Shumë shoqata sporti të mirëpresin ty që dëshiron të garosh por edhe ty që vetëm do të mereshh me sport pa garuar.

CILAT SPORTE EKZISTOJNË?

Mbi tre milion njerëz në Suedi janë anëtarë në ndonjë shoqatë sporti, gati çdo i treti person, prandaj sporti zakonisht quhet si "Lëvizja më e madhe popullore në Suedi". Në tërë vendin ka shoqata sportive, si për sporte individuale si psh. gjimnastika, sportet luftarake apo skijimi ashtu edhe sporte ekipore si

psh. futbollli, basketbolli dhe hokej mbi akull. Disa sporte zhvillohen kryesisht gjatë verës, të tjerat gjatë dimrit. Pyete fqinjin tuaj, mësuesin e fizkulturës apo ndonjë shok dhe informohu se çfarë sportesh ka aty ku banon ti dhe testoj deri sa të gjesh sportin që e do.

PUNË NË SHOQATË ËSHTË JO-FITIMPRURËSE

Të gjitha shoqatat sportive në themel janë vullnetare. Kjo do të thotë se nuk ka ndonjë pronar apo kërkesë profiti. Antarët vendosin se si të zhvillohet veprimtaria dhe japin kontribut më gjëra të ndryshme. Kjo do të thotë që psh. mbrëmjeve dhe fundjavëve të kenë përgjegjësi stërvitjet, shitjet në kafe, apo të jenë funksionar në gara që i organizon shoqata. Shoqata sportive nuk është si një ndërmarrje

ku të punësuarit marin rrogë.

Ekonomia e shoqatës përbëhet nga paratë e anëtarisë dhe ndihmat nga komuna e shteti. Por zakonisht kjo nuk mjafton për të paguar shpenzimet për kohën për stërvitje, qiranë e lokalit dhe udhëtimet për gara. Prandaj është e rëndësishme që të gjithë anëtarët të ndihmojnë në mënyrë vullnetare, si fëmijët ashtu edhe të rriturit.

KËSHTU MUND TË BËHESH ANËTAR

Po thuhet që të gjitha shoqatat sportive i kanë uebsajtet e tyre apo gjenden në rrjetet sociale ku shkruan se cilin mund ta kontaktosh për tu bërë pjesë e një shoqate. Zakonisht mund të provosh atë sport nja dy herë për të testuar se a të pëlqen apo jo. Por më vonë duhet të anëtarsohesh për të vazhduar stërvitjet dhe garat në shoqatë.

Për t'u anëtarësuar e deklaron emrin tuaj, e-mailin, adresën postare dhe numrin personal.

SA KUSHTON?

Sa kushton anëtarësia, kjo varet se për çfarë sporti bëhet fjalë dhe në cilin pjesë të vendit banoni.

Në disa sporte ti duhet vet të rregullosh pajisjet të cilat nevojiten. Disa i blejnë pajisjet e veta të përdorura në dyqane second hand apo përmes shpalljeve në internet. Një alternativë tjetër është që ta pyesësh shoqatën tuaj sportive nëse ka pajisje që mund t'i huazosh. Ka po

Pas kësaj ti e paguan anëtarësinë. Anëtarësia paguhet një herë në vit derisa dëshiron të jeshë pjesë e shoqatës. Arsyeja pse duhet lënë numrin personal është se nganjëherë nevojitet për sigurime dhe kontribute. Por numri nuk përdoret për ndonjë qëllim tjetër jashtë shoqatës.

Shoqatat kanë mundësi t'i trajtojnë të dhënat personale për ty që jeton me ID të mbrojtur apo ke numër koordinimi.

ashtu organizata që ndihmojnë. Si shembull është Fritidsbanken, e cila huazon falas pajisje sportive për 14 ditë për ata që duan të testojnë një sport apo aktivitet i kohës së lirë.

Edhe nëse kushton para të jesh anëtar në një shoqat sporti ti mer shumë gjëra mbrapa. Psh. stërvitje, udhëtime për gara, shoqëri, siguri dhe mundësi për të njohur shoqëri të re.

ANËTARËT VENDOSIN

Shoqatat jo-fitimprurëse janë demokratike. Kjo do të thotë se ti si anëtar ke të drejtë të ndikosh në punën e shoqatës. Një herë në vit shoqata e mban mbledhjen vjetore ku të gjithë ata që e kanë paguar anëtarësinë mund të diskutojnë dhe të vendosin së çfarë do të bëjë shoqata gjatë vitit vijues dhe se si të përdoren paratë.

Në mbledhjen vjetore të gjithë anëtarët e kanë nga një votë. Votën mund ta përdorësh për të zgjedhur ata që i dëshiron në kryesinë e shoqatës. Kryesia është një grup persona që e kanë përgjegjësinë që shoqata t'i zbatoj rregullat e përbashkëta dhe kujdeset që shoqata t'i realizoj ato vendime që janë mar në mbledhjen vjetore.



Pyetje të shkurtura dhe përgjigje

1. Kush mund të bëhet anëtar i një shoqate?

Përgjigje: Synimi i sportit është që të gjithë duan mund të bëhen pjesë e tij! Sot mund të duket ndryshe nëpër shoqata, duke u bazuar psh. në formë dhe numrin e vendeve.

2. A është e sigurt të dërgoj fëmijun tim në një shoqatë sporti?

Përgjigje: Ne bëjmë gjithçka që është e mundur që të gjithë fëmijët të ndjehen të sigurt dhe ka kurse ku udhëheqësit e shoqatës i vijnë e që bëjnë fjalë për krijimin e ambienteve të sigurta për fëmijë. Shoqatat sportive e zbatojnë bazën e vlerave të cilat janë rregulla të përbashkëta se si të sillemi ndaj njëri-tjetrit, si psh. që nuk guxon të vij në shprehje bullizmi, dhuna dhe racizmi në shoqatë.

3. Çka duhet të paguaj?

Përgjigje: Taksën e antarësisë e në

disa raste edhe shpenzimet për stërvitje dhe pajisje. Duke u angazhuar në shoqatë, duke qenë psh. funksionar gjatë garave ose duke shitur lloti, ti jep kontribut që shpenzimet të mbahen në nivel të ultë.

4. Përse të bëhem pjesë e një shoqate?

Përgjigje: Sepse të jep ty dhe fëmijut tuaj një mundësi për stërvitje, të ndjeheni mirë, të kënaqeni dhe të takoni njerëz të tjerë. Për shumë veta shoqata sportive është vendi ku i kanë shokët e vet, vendi për të cilën i mer malli pas shkollës apo punës dhe ku mund të marrin pjesë, ndikojnë dhe angazhohen bashkë me të tjerë. Për disa mund të jetë edhe rruga për tu futur në tregun e punës.

5. Çka përfitoj si anëtar?

Përgjigje: Si anëtar ti ke mundësi që të ndjehesh pjesë e një bashkësie, të ndikosh në veprimtarinë e shoqatës dhe të marrësh pjesë në aktivitete që u ofrohen të gjithë antarëve.

Fakte RF-SISU

Federata e shoqatave të sportit (RF)

është një organizatë që e mbledh lëvizjen sportive dhe e ka për detyrë që të përkrah dhe të zhvilloj sportin në Suedi. RF përbëhet nga 70 shoqata speciale sporti, 19 000 shoqata sporti dhe afërsisht, 3,3 milionë antarë. RF gjendet në tërë vendin në nivelin lokal dhe rajonal.

SISU Arsimuesit sportiv (SISU)

është shoqata e studimit e vet lëvizjes sportive. SISU ofron arsimim dhe trajnim për shoqata sporti për t'u dhënë njohuri dhe forcë mendimeve, ideve dhe dëshirave të njerëzve për tu zhvilluar. SISU gjendet po ashtu në tërë vendin në nivelin lokal dhe rajonal.



Fjalorthi

Lëvizje popullore – Një grup njerëzish që kanë një interes të përbashkët dhe organizohen në tërë vendin.

Funksionar – Një person në një shoqatë sporti që ndihmon psh. në një garë sportive. Mund të bëhte fjalë për punën në kioskë, tu tregosh vizitorëve ku të ulen apo të jesh gjyqtar që kujdest për respektimin e rregullave.

Jo-fitimprurëse – Një shoqatë apo organizatë që nuk drejtohet për përfitim. Një shoqatë sporti është jo-fitimprurëse pasi që antarët ndihmojnë dhe marrin përgjegjësi për detyra të ndryshme. Shoqatat sportive nuk janë të njëjta si ndërmarrjet ku të punësuarit marrin rrogë.

Shoqatë sporti – Një shoqatë sporti përbëhet nga një grup njerëzish që stërviten dhe garojnë bashkë në një apo disa sporte. Shkurtesa e një shoqate

sporti në suedisht është IF. Por ka shoqata që kanë edhe shkurtesa tjera, IK (klub sporti), IS (shoqëri sporti) apo SK (klub sporti).

Taksa e antarësisë – Për të qenë pjesë e një shoqate ti duhet të antarësohesh. Ti bëhesh anëtar duke i'a paguar një taksë shoqatës, pra një shumë e parave, një herë në vit.

Kryesi – Çdo shoqatë sporti e ka një kryesi e cila votohet nga antarët në mbledhjen vjetore. Detyra e kryesisë është të udhëheq punën e shoqatës deri në mbledhjen e ardhshme vjetore.

Mbledhje vjetore – Një mbledhje e cila mbahet një herë në vit për të gjithë antarët e shoqatës. Çdo anëtar e ka një votë në mbledhjen vjetore. Gjatë mbledhjes meret vendim se cilët persona do të hyjnë në kryesi dhe se si do të duket plani i veprimtarisë së shoqatës për vitin vijues.